



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 113/13
Prishtinë, më 03.07.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Sevdije Lama, Hykmete Bajrami dhe Duda Balje.

Munguan: Albana Fetoshi dhe Xhevdet Nezrija.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Imba Rudaku, Arbëreshë Kosumi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Agim Krasniqi Drejtor i Buxheti në MF, Muhamed Krasniqi, Besim Kajtazi, Zahir Bajrami nga Zyra e Kryeministrit, Lukas Fischer dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 19.06.2013 dhe 26.06.2013;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës me Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja kryetarja njoftojë anëtarët që e keni marr një raport me amendamente nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri për Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike, në bazë të analizës që i është bërë Projektligjit dhe amendamenteve të komisionit funksional shifet që nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Propozojë që të futet si pikë shtesë e rendit të ditës.

Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës me plotësime: shtohet pika e re 4, Shqyrtimi i Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike me amendamentete e komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik,

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 19.06.2013 dhe 26.06.2013

Kryetarja konstatoi se procesverbalet miratohen pa vërjetje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës me Raportin e Komisionit Funkcional për Legjislacion

Kryetarja njoftoi se komisioni funksional për legjislacion ka rekomanduar që mos me miratua projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës dhe ti kthehet propozuesit që ta harmonizojë me kushtetutën. Nga deklarata e Ministrisë së Financave shohim që parashihet që të jenë edhe dhjetë punëtor të ri, me paga prej 73,000 euro dhe 235,000 për mallra dhe shërbime. Ministria nuk ka paraparë buxhet shtesë dhe nuk kemi vlerësim të koston për zbatimin e këtij projektligji. Zyra e kryeministrit duhet të na jap shpjegimi se a është trajtuar kosto shtese në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2014-2016, në rishikimin e buxhetit për vitin 2013 dhe a është duke u trajtuar tash gjatë fazës së përgatitjeve së projektbuxhetit për vitin 2014.

Besim Kajtazi ky ligj nuk është në kundërshtim as me kushtetutën as me ligjin për përfundimin e pavarësisë së mbikqyrur. Sa i përket koston financiare gjatë procesit të hartimit ne kemi pas parasysh që mos të krijohet një agjencion i ri për shkak të koston financiare, pasi që fillimisht është kërkuar të krijohet një agjencion i ri. Ideja ka qenë që Agjencia për Pronë ti bashkangjitet edhe një kompetencë shtesë, të cilën e kemi paraqitur në ligj që ka të bëjë me krahasimin dhe verifikimin e të dhënave kadastrale që do të merren nga Serbia dhe përmes Agjencisë kadastrale dhe kësaj Agjencie. Shtimi i kësaj kompetence të krahasimit dhe verifikimit ka rezultu me kërkesën edhe të gjashtë ekspertëve, që për momentin nuk i ka AKP-ja dhe tre anëtarëve të bordit që janë themeluar me ligjin e ri të cilët janë në harmoni dhe me pozitat aktuale.

Latif Gashi kemi një rekomandim të Komisionit të legjislacionit që votat janë të ndara përgjysmë katër për dhe katër kundër dhe ju si përfaqësues a keni qenë në takim dhe a keni mundur mi sqaruar ato nene që janë kondensuar nga ky komision që me të vërtet nuk janë në kundërshtim me kushtetutën. Çështjen e ndikimeve financiar nuk e shoh si problem ngase keni vepruar në mënyrë të arsyeshme që keni zgjedhur një agjencioneve që ka qenë i krijuar dhe vetëm shtohet një numër i ekspertëve dhe anëtarëve të bordit.

Agim Krasniqi e paraqet qëndrimin e Ministrit por edhe te Qeverisë ne e dimë se ka kosto shtesë ky PL dhe mendojmë se kjo kosto është e ndëlidhur me pikën 2 të nenit 9. Pas diskutimeve, në fund ka dal qëndrimi i Qeverisë se projektligji duhet përkrahur. Si rezultat e kësaj ne kemi marrë detyrime që zbatimin e ligjit ta bëjmë përmes rregullimeve të brendshme, pasi që nuk mund të shtojmë punëtorë të rinj për të respektuar marrëveshjen me FMN. Në draft buxhetin e vitit 2014 do ta përfshijmë edhe këtë pjesë.

Sali Asllanaj agjencioni katastral qfarë bënë, pse nuk e kryen edhe këtë punë ose të jetë një kombinim i këtyre dy agjencioneve. Edhe pse shpenzimet nuk po duken të shumta, por krijimi i agjencionit të ri dhe numrit të ri të punëtorëve krijon strukturë të re e cila e shërndan buxhetin e Kosovës. Pse të dy agjencionet të mos e formojnë një komision për verifikim të të dhënave.

Kryetarja nëse ne e marrim edhe e analizojmë projektligjin, nuk është i përcaktuar saktësisht nëse duhet te shtohet numri i punëtorëve, por për shkak të kostos shtesë ne mundemi me ba një kufizim në projektligj se nuk pranohen punëtor të rinj, sepse agjensioni kosovar i pronave ka numër të mjaftueshëm të të punësuarve dhe nëse duhen shtesë, kjo mund të bëhet me rregullime të brendshme. Ne si komision mund të rregullojmë disa qështje financiare të projektligjit, në radhë të parë se kujt i përgjigjet agjencia, dërgon raportin vjetor, mandej qështja e pagave të bordit që është paraparë të caktoj Kuvendi, pasi që Kuvendi nuk cakton paga dhe qështjet tjera të natyrës financiare.

Latif Gashi vlerësoj se nuk mori përgjigje nga përfaqësuesi i zyrës së Kryeministrit, çështja kryesore është se a është njoftuar Komisioni për Legjislacion para apo pasi që janë bërë rekomandimet, a është njoftuar se interpretimi është i gabuar dhe a jeni ftuar gjatë shqyrtimit? Sa i përket çështjes financiare të ligjit drejtori e shpjegoj se ajo mund të kaloj me rregullime të brendshme apo shtim të buxhetit, propozoj që të formohet një grup punues.

Kryetarja ne mund të japim rekomandimin tonë dhe mendoj se po të fshihen dy apo tri nenet, të rregullohen nga Komisioni.

Sipas propozimeve, Komisioni njëzëri caktoi grupin punues, i cili në afatin më të shpejtë shqyrton projektligjin dhe raportin e dërgon për miratim në Komision. Anëtarët e grupit punues, u caktuan: Latif Gashi (kryesues), Sali Asllanaj dhe Duda Balje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike me amendamentete e komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Komisioni njëzëri, nxorri këtë

Rekomandim

Projektligji për tregtinë e mallrave strategjike dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

5. Të ndryshme

Kryetarja njoftoj se në seancën e radhës plenare, në rend dite do të jetë shqyrtimi i rishikimit të buxhetit 2013, dhe nëse kalon në lexim të parë, të premtën të shqyrtohet pjesa tekstuale të Projektligjit në komision, kurse nga dita e hënë të formohen grupet punuese. Arsyeja e kërkesës për takim është çështja e nenit ka të bëjë me të burgosurit politik, me ndarjen kontingjente që është propozuar në Projektligj. Më dt.05 Qeveria duhet të njoftoj Fondin Monetar Ndërkombëtar që ky amendament ka kaluar i riformuluar në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Mbledhja përfundoi: 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj